



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:039066  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05760188

KPPP.nr.449/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Alpha Private Security Sh.p.k me numër të regjistrimit të biznesit 70236758, me seli në rrugën “Rexhep Krasniqi” Llam. A. Nr. 8 Komuna Prishtinë kundër debitorit Ministria e Shëndetësisë me seli në rrugën “Zagrebit” p.n Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.487/18 të datës 19.07.2018, të Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 30.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit Ministria e Shëndetësisë, ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.487/18 të datës 19.07.2018 i Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj, për pjesën e detyrimit në shumën prej 1.614,03 € (njëmijë e gjashtëqind e katërbëdhjetë euro e zero tre cent).
- II. REFUZOHET pjesërisht si i pa bazuar prapësimi i debitorit Ministria e Shëndetësisë, ashtu që MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.487/18 të datës 19.07.2018 i Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj për pjesën e detyrimit në shumën prej 563,13 €.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit Alpha Private Security Sh.p.k., ndaj debitorit Ministria e Shëndetësisë”, sipas urdhrit P.nr.487/18 të datës 19.07.2018 i Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj, për pjesën e detyrimit në shumën 1.614,03 €.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.487/18 të datës 19.07.2018, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – fatura me numër43/2016 të datës 01.12.2016, nr. 05/2017 të datës 01.03.2017, nr. 09/2017 të datës 01.04.2017 dhe 13A/2017 e datës 21.04.2017 me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri t'ia paguaj borxhin total kreditorit në shumë prej 2,177.43 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, nga rënia në vonesë e deri në ditën e pagesës definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se debitori ka bërë pagesat e faturave për as kohë sa janë kryer shërbimet, meqenëse ankes kontrata është lidhur deri në lidhjen e kontratës së re përkatësisht deri me dt. 12.04.2017 kur është lidhur kontrata me operator tjerë duke i propozuar gjykatës në fund që të aprovohet prapësimi ndërsa urdhri përmbarimor të shfuqizohet.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar ngase ka deklaruar se i ka realizuar pagesa ndërsa prapësimi nuk i ka bashkangjitur as një provë, ndërsa ankes kontrata është lidhur deri më lidhjen e kontratës së re me operator tjerë, dhe konsideron se pas kësaj periudhe nuk ka pasur obligim ndaj debitorit, pos tjerash ka deklaruar se debitori nuk i ka bashkangjitur prapësimi as një provë materiale dhe si rrjedhojë prapësimi duhet të refuzohet në tërësi si i pa bazuar ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata në ri procedurë duke i pasur parasysh sugjerimet dhe vërejtjet Gjykatës së Apelit të Kosovës sipas vendimit Ac.nr.2773/19 të datës 18.05.2020 e pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përmbarimor Përmbarimor P.nr.487/18 të datës 19.07.2018, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori

sipas faturave 05/2017 të datës 01.03.2017, nr. 09/2017 të datës 01.04.2017 dhe 13A/2017 e datës 21.04.2017, për shkak se të njëjtat nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP –së.

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata gjeti se faturat me numër 05/2017 të datës 01.03.2017, nr. 09/2017 të datës 01.04.2017 dhe 13A/2017 e datës 21.04.2017 në bazë të cilave është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se faturat në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht të njëjtat nuk përmbajnë as nënshkrimin dhe vulën e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga debitori në ndonjë mënyrë.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr.487/18 të datës 19.07.2018 për shumën në vlerë prej 563,13, për faktin se faturat me numër 43/2016 të datës 01.12.2016 në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësonë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat sa i përket pjesës së borxhit si në pikën II të dispozitivit, bazohet në dokumentet e besueshme respektivisht faturat e lartcekur të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të

LPP-së, meqenëse në këtë fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat/shërbime të cilat kanë qenë objekt i kësaj faturave, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Në rastin konkret rezulton se faturat është dorëzuar në origjinale nga ana e kreditorit dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, gjë e cila vërtetohet edhe nga nënshkrimi i debitorit si dhe fakti që fatura asnjëherë nuk është kontestuar nga debitori.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe kreditorit paraqitur në përgjigje në prapësim, dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin tjera të paraqitura nga debitori, sepse të njëjtat pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.449/22, datë 30.05.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.